



Republika e Kosovës



Komuna e Vushtrrisë

Drejtoria për Arsim

10 Nr. 846/17

Datë: 03.11.2017

Bazuar në Nenin 8, paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit të Punës Nr.03/L-212, nenin 5. Pika c, të Ligjit nr. 03/L – 068 për Arsimin në Komunitatet e Republikës së Kosovës, si dhe Udhëzimit Administrativ Nr.06/2015 për Normativin mbi kuadrin profesional të arsimit të përgjithshëm, dhe aprovimin nga MEF-i Nr 3470-1/17 dt.03.11.2017. Drejtoria Komunale e Arsimit në Vushtrri, shpall këtë :

KONKURS

Për vendet e lira punës

- **SHFMU ” Abdyl Frashëri”Druar**
1 Mësues/e klase me kohë të caktuar.
- **SHFMU “Bajram Curri”Dumnicë e Llugës**
1 Mësues/e klase me kohë të caktuar

Kushtet për mësimdhënës :

Për këto vende të punës kërkohet kualifikimi përkatës profesional, sipas Udhëzimit Administrativ të MASHT-it Nr.06/2015 Për Normativin mbi Kuadrin Profesional të Arsimit të përgjithshëm.

Dokumentacioni i nevojshëm për konkurrim :

- Formulari i aplikimit i cili merret në zyrën e arkivit Komunal
- Diploma (Certifikata e diplomimit jo më e vjetër se gjashtë muaj) e fakultetit e fotokopjuar dhe e vërtetuar nga noteri
- Fotokopja e letërnjoftimit
- Vërtetimi i përvojës së punës
- Vërtetimi nga gjykata se nuk është nën hetime
- Certifikatat e trajnimeve

Dokumentet e dorëzuara nuk kthehen. Konkursi mbetet i hapur 8 ditë prej ditës së shpalljes në shtyp. Dokumentet e pakompletuara nuk shqyrtohen.

Intervistimi me shkrim i kandidatëve mbahet më 14.11.2017, në ora: 11:00 në sallën e Kuvendit Komunal.